

URDHËR
Nr. 498, datë 4.12.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 369, DATË 19.9.2019, “PËR HAPJEN E THIRRJES SË DYTË PËR APLIKIME PËR PROGRAMIN IPARD II”

Mbështetur në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”; në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”; në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, të ndryshuar; në marrëveshjen kuadër, marrëveshjen sektoriale për IPARD II dhe marrëveshjen e financimit,

URDHËROJ:

1. Në pikën 4 (katër) të urdhrit nr. 369, datë 19.9.2019, “Për hapjen e thirrjes së dytë për aplikime për programin IPARD II”, ndryshohet si më poshtë: “Shtyhet afati për aplikime për thirrjen e dytë për aplikime nga programi IPARD II deri në datën 15 janar 2020”. Çdo aplikim që vjen pas datës 15.1.2020 do të refuzohet.

2. Lënien në fuqi të pikave të tjera.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Frida Krifca